

## Pyetjet më të shpeshta të studentëve

Kategoritë:

- Aplikimi/Regjistrimi
- Programi i studimit
- Statusi i studentit
- Pagesat
- Ligjërata & Ushtrime
- SEMS
- Provimet
- Bursat/Praktika profesionale
- Orari i punës së zyrtarëve
- Diplomimi

### **Aplikimi/Regjistrimi**

#### **1. Si të aplikoj në Fakultetin Ekonomik?**

-Pasi që të shpallen rezultatet e testit të maturës, hapet konkursi në Universitetin e Prishtinës. Në konkurs specifikohen fakultetet, departamentet, kuotat e studimit, lëndët e provimit, data dhe ora e provimit. Në ëbfaqen <http://apliko.uni-pr.edu/> plotësohet formulari për aplikim.

#### **2. Si mund t'i tërheq dokumentet nëse nuk jam pranuar në fakultet?**

-Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet nëse nuk ke arritë që të pranohesh në fakultet. Ato i tërheq tek referenti i departamentit përkatës, në orarin e publikuar në ëbfaqen e fakultetit <http://ekonomiku.uni-pr.edu/>.

#### **3. A mund të ndryshoj statusin e studimeve nga me korrespondencë në të rregullt?**

-Po mund ta ndryshosh statusin e studimeve nga student me korrespondencë në student të rregullt, por vetëm pasi të përfundosh të gjitha provimet e vitit të parë dhe të arrish mesatare mbi 8.0. Për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen tek kategoria e njoftimeve në ëbfaqe të fakultetit pasi të hapet konkursi.

#### **4. Si është procedura e aplikimit për bursë?**

-Universiteti i Prishtinës në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues, shpallë konkursin për aplikim për bursë në ëbfaqen e Fakultetit Ekonomik <http://ekonomiku.uni-pr.edu/>. Për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen tek kategoria e njoftimeve në ëbfaqe të fakultetit pasi të hapet konkursi.

### **Programi i studimit**

#### **1. Çfarë literature mund të përdoret për t'u përgatitur për provimin pranues?**

- Provimi pranues bazohet në lëndët : Hyrje në Ekonomi dhe Matematikë. Këto libra gjenden në bibliotekat dhe libraritë e qytetit.

#### **2. Ku mund të gjenden syllabuset e lëndëve?**

-Syllabuset gjenden në website-in e fakultetit në vegzën e mëposhtme:  
<http://ekonomiku.uni-pr.edu/Departamentet.aspx>

### 3. Ku mund të siguroj literaturën e nevojshme për studime?

-Literatura e nevojshme mund të sigurohet në libraritë e qytetit.

### 4. Sa lëndë zgjedhore duhet të zgjedhen në një semestër?

- Në semestrin e dytë, nga tri lëndë zgjedhore duhet të zgjedhet një.

Nga semestri i tretë e tutje, studenti duhet të zgjedh dy lëndë zgjedhore për semestër.

Për informata më të hollësishme vizitoni webfaqen : [http://ekonomiku.uni-pr.edu/Planprogramet-\(1\).aspx](http://ekonomiku.uni-pr.edu/Planprogramet-(1).aspx)

### 5. A mund ta ndërroj lëndën zgjedhore?

-Pas zgjedhjes së lëndëve ato shndërrohen në lëndë obligative dhe nuk mund të ndërrohet lënda e as profesori.

### 6. A mund ta ndërroj departamentin e studimeve?

-Departamenti i studimeve mund të ndërrohet vetëm pas vitit të parë, mirëpo duhet plotësohen këto kushte : a) Të jetë student i rregullt dhe b) Të ketë notën mesatare mbi 8.0

Kërkesa dorëzohet në dekanat dhe shqyrtohet nga Komisioni i studimeve. Vendimi i komisionit shpallet në website.

### 7. A mund të vazhdoj studimet Master në një program tjetër prej atij Bachelor?

-Studenti mund të përcaktohet për cilindo drejtim të studimeve Master pavarësisht drejtimit në studimet Bachelor.

### 8. A mund ta zgjedh një profesor të cilin nuk e kam në orar?

-Ndjekja e ligjëratave dhe paraqitja e provimit mund të bëhet vetëm tek profesori që figuron në orarin e ligjëratave dhe në SEMS.

### 9. A mund të diplomoj tek një profesor i cili nuk është i programit që kam studiuar?

- Studenti mund të diplomoj tek cilido profesor i cili ligjëron lëndët të cilat janë në planprogram të drejtimit të tij.

### 10. Nëse jam i regjistruar me korrespondencë, a kam të drejtë të hyjë në kolokviume?

-Vendimi për këtë është në kompetencën e profesorit.

## Statusi i studentit

### 1. Si ta ndërroj statusin e studentit nga me korrespondencë në të rregullt?

-Ndërrimi i statusit nga student me korrespondencë në student i rregullt lejohet për studentët me notë mesatare mbi 8.0 dhe që kanë përfunduar provimet më së largu në Shtator të atij viti akademik. Megjithatë për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen në website-in të fakultetit pasi të hapet konkursi për ndërrim të statusit.

### 2. A kam të drejtë t'i regjistroj studimet në dy fakultete?

-Regjistrimi i fakultetit të dytë mund të ndodhë vetëm pas përfundimit të fakultetit të parë.

### 3. Cilat janë kushtet/kriteret për lirim nga semestri?

-Për kushtet apo kriteret për lirim nga pagesa e semestrit studentët njoftohen me kohë nëpërmjet lajmërimeve në faqen zyrtare të Universitetit/Fakultetit pasi të hapet konkursi.

#### 4. Si të aplikoj për lirim nga semestri?

-Për lirim nga semestri kërkohen dokumentet që vërtetojnë statusin e studentit dhe dokumentet e tjera percjellëse që vërtetojnë kategorinë nëpërmjet së cilës studenti ka aplikuar për lirim nga semestri. Megjithatë, për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen në website-in e fakultetit pasi të hapet konkursi.

#### 5. Si mund ta marr transkriptën zyrtare të notave?

-Në SEMS nxirret fletëpagesa prej 2.50 € e cila paguhet në institucione e licencuara për pagesa. Fletëpagesa bashkë me ID kartelën dorëzohet në sportelin e departamentit. Referenti ju njofton për terminin e tërheqjes së dokumentit.

#### 6. Si ta marr vërtetimin që jam student i fakultetit ekonomik?

-Për ta marrë vërtetimin e statusit të studentit duhet të dorëzohet ID kartela tek sporteli i departamentit. Referenti ju njofton për terminin e tërheqjes së dokumentit.

#### 7. Në çfarë gjuhe mund ta marr vërtetimin e statusit të studentit dhe transkriptën e notave?

-Transkripta mund të merret vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa vërtetimi i statusit të studentit mund të merret në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

#### 8. Kur bëhet aplikimi, fotografimi dhe marrja e ID kartelës?

-Menaxhmenti i UP-së ka vendosur që me procedurat e pajisjes me ID kartelë merret Administrata Qendrore. Për terminin e aplikimit, fotografimit dhe pajisjes me ID kartelë shpallet njoftimi gjatë semestrit të parë në website-in e fakultetit.

#### 9. A janë të obligueshme ligjëratat dhe ushtrimet?

-Ligjëratat dhe ushtrimet janë të obligueshme për studentët e rregullt.

#### 10. A duhet ta paguaj semestrin nëse kam provime të mbetura pas përfundimit të studimeve? -----

-Pagesa e semestrit të fundit vlen 1 vit pas përfundimit të vitit të tretë.

Psh: Nëse ligjëratat/ushtrimet perfundojnë në Qershor të vitit 2017, studenti nuk ka nevojë ta paguaj semestrin deri në shtator të vitit 2018.

Më pas, nëse studenti nuk ka arritë që t'i mbarojë provimet e vitit të fundit duhet ta paguaj semestrin e pestë dhe të gjashtë, kjo përsëritet tetë herë, nëse pas dyfishit të viteve të studimeve (Gjashtë vite) humbet statusi i studentit.

#### 11. A lejohet pjesëmarrja në kolokviume për studentët me korrespondencë?

-Vendimi për këtë është në diskrecionin e profesorit.

#### 12. Sa vite kam të drejtë mbajtjen e statusit Student?

-Statusi student vlen sa dyfishi i viteve të atij programi.

Psh: Në qoftë së programi përkatës ka tre vite, atëherë studenti e ruan statusin e tij për 6 vite.

#### 13. Sa vite kam të drejtë të pauzoj gjatë studimeve bachelor?

-Të drejtën e pauzës pa paralajmërim studenti e ka për një vit. Për çfarëdo pauze për qëllime specifike duhet të dorëzohet kërkesë e protokoluar në dekanat.

#### 14. Sa vite kam të drejtë të pauzoj mes studimeve master?

-Të drejtën e pauzës pa paralajmërim studenti e ka për një vit. Për çfarëdo pauze për qëllime specifike duhet të dorëzohet kërkesë e protokoluar në dekanat.

### 15. Si shkon procedura për marrje të statusit studentor për punësim sezonal në Gjermani (immatrikulation)?

-Për t'u pajisur me *immatrikulation* duhet të merret një vërtetim zyrtar i statusit studentor. Vërtetimi i statusit të studentit dhe *immatrikulation*-i protokolohehen në zyrën 7. Në këtë zyre jepën udhëzimet si të plotësohet *immatrikulation*-i. Në fund *immatrikulation*-i arkivohet.

## Pagesat

### 1. Si është procedura për pagesë të semestrit bachelor?

-Për ta paguar semestrin në fakultet, duhet të nxirret fletëpagesa nga SEMS-i (4 kopje), të kryhet pagesa, të plotësohet **fletëregjistrimi (shkarko këtu)**. Të gjitha dokumentet e plotësuara dorëzohen tek referenti i departamentit.

### 2. Si është procedura për pagim të semestrit masters?

-Për ta paguar semestrin në fakultet, duhet të nxirret fletëpagesa nga SEMS-i (4 kopje), të kryhet pagesa, të plotësohet **fletëregjistrimi (shkarko këtu)**. Të gjitha dokumentet e plotësuara dorëzohen tek referenti i departamentit.

### 3. Sa është pagesa për semestër të programit bachelor?

-Viti i parë është pa pagesë, ndërsa për semestrat e tjerë pagesa për studentët e rregullt është 25 €, ndërsa për ata me korrespondencë 125 €.

### 4. Sa është pagesa për semestër të programit master?

-Pagesa për semestër në nivelin master për 150 €.

### 5. Cilat janë kushtet/kriteret për lirim nga semestri?

-Për kushtet apo kriteret për lirim nga pagesa e semestrit studentët njoftohen me kohë nëpërmjet lajmërimeve në faqen zyrtare të Universitetit/Fakultetit pasi të hapet konkursi.

### 6. Si të aplikoj për lirim nga semestri?

-Për lirim nga semestri kërkohen dokumentet që vërtetojnë statusin e studentit dhe dokumentet e tjera percjellëse që vërtetojnë kategorinë nëpërmjet së cilës studenti ka aplikuar për lirim nga semestri. Megjithatë, për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen në website-in e fakultetit pasi të hapet konkursi.

### 7. A duhet ta paguaj semestrin nëse kam provime të mbetura pas përfundimit të studimeve?

-Pagesa e semestrit të fundit vlen 1 vit pas përfundimit të vitit të tretë.

Psh: Nëse ligjeratat/ushtrimet perfundojnë në Qershor të vitit 2017, studenti nuk ka nevojë ta paguaj semestrin deri në shtator të vitit 2018.

Më pas, nëse studenti nuk ka arritë që t'i mbarojë provimet e vitit të fundit duhet ta paguajë semestrin e pestëtë dhe të gjashtë, kjo përsëritet tetë herë, nëse pas dyfishit të viteve të studimeve (Gjashtë vite) humbet statusi i studentit.

### 8. Nëse ka kaluar afati i paraqitjes së provimeve por nuk i kam paraqitur ato, ku duhet të drejtohem?

-SEMS-i ka sistem strikt për paraqitje të provimeve, vëmendja mbi njoftimet dhe lajmërimet mbi paraqitjen e provimeve duhet të jenë maksimale. Nëse provimet nuk janë paraqitur brenda afatit të shpallur, nuk mund të paraqiten deri në afatin e ardhshëm.

### 9. A mund të paguaj semestrin online (debit/kredit kartelë)?

-Mund të paguhet përmes e-banking, mirëpo është obligative që studentit të ketë vërtetim të pagesës dhe ta dorëzoj tek referenti i departamentit.

## Ligjërata/Ushtrime

### 1. A janë ligjëratat dhe ushtrimet obligative?

-Varësisht nga statusi i studimeve, ndërron edhe detyrimi për vijim të ligjëratave dhe ushtrimeve. Për studentët me status të rregullt të studimeve, ligjëratat dhe ushtrimet janë obligative. Për studentët që studiojnë me korrespondencë, ligjëratat dhe ushtrimet nuk janë obligative.

### 2. Në çfarë orare duhet ndjekur ligjëratat dhe ushtrimet?

-Orarin për ligjërata dhe ushtrime e përcakton fakulteti. Menaxhmenti i fakultetit në cdo fillim të semestrit publikon grupet e studentëve për vijim të ligjëratave dhe ushtrimeve. Kjo bëhet pas regjistrimit të lëndëve në SEMS.

### 3. A mund të përshtatet orari i ligjëratave dhe ushtrimeve sipas dëshirës?

-Orari përcaktohet nga fakulteti dhe si i tillë nuk mund të ndërrohet.

### 4. A mund të vijohen ligjëratat tek profesori i po asaj lënde që nuk figuron në orar?

-Ligjëratat dhe ushtrimet duhet të vijohen vetëm tek profesori që korrespondon me grupin që i përket. Si rrjedhojë edhe provimi në SEMS paraqitet vetëm tek profesori në të cilin ke vijuar ligjëratat.

### 5. Cka janë kolokviumet (Testet semestrale)?

-Kolokviumet (lat colloquium) paraqet një vlerësim të pjesshëm seminarik rezultati i të cilit kontribon notën përfundimtare. Mbi numrin, datën e mbajtjes dhe kriterin e vlerësimit për testet semestrale njoftoheni në syllabusin e lëndës.

### 6. A lejohet pjesëmarrja në teste semestrale (kolokviume) nëse kam statusin e studentit me korrespondencë?

-Nëse je student me korrespondencë, mirëpo vijues i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve ke të drejtën të ju nënshtrohesh testeve semestrale. Megjithatë sugjerohet konsultimi paraprak me profesorin e lëndës.

## SEMS

### 1. Si mund të merret transkripta e notave?

-Në SEMS nxirret fletëpagesa prej 2.5 €, e cila paguhet në ndonjë nga institucionet e licencuara për pagesa. Fletëpagesa bashkë me ID kartelën dorëzohen në sportelin e departamentit. Referenti ju njofton për terminin e tërheqjes së dokumentit.

### 2. Sa ka kohë për refuzimin e notës në SEMS?

-Nga momenti kur nota vendoset në SEMS ajo mund të refuzohet brenda 48 orëve. Pas kësaj periudhe nota bartet në transkriptën e notave.

### 3. Sa herë kam të drejtë ta paraqes një provim?

-Provimi i njëjtë mund të paraqitet tri herë. Nëse pas herës së tretë nuk kalohet provimi, vlerësimi bëhet me komision. Nëse as pas herës së katërt studentit nuk arrinë ta kalojë provimin, automatikisht e humb vitin.

#### 4. Nëse nuk mund t'i paraqes provimet në SEMS, ku duhet të drejtohem?

-Studenti duhet të sigurohet se procedura e regjistrimit të semestrit është përfunduar me sukses dhe se është brenda afatit të mundur për paraqitjen e provimeve. Për çfarëdo problemi tjetër software-ik, studentët duhet të drejtohen tek zyrtari i IT-së në fakultet.

#### 5. Nëse ka kaluar afati i paraqitjes së provimeve por nuk i kam paraqitur ato, ku duhet të drejtohem?

-SEMS-i ka sistem strikt për paraqitje të provimeve, vëmendja mbi njoftimet dhe lajmërimet duhet të jetë maksimale. Nëse provimet nuk janë paraqitur brenda afatit të shpallur, nuk mund të paraqiten deri në afatin e ardhshëm.

#### 6. Nëse më del nota gabimisht në SEMS, ku duhet të drejtohem?

-Nëse nuk kanë kaluar 48 orë nga vendosja e notës në SEMS, atëherë duhet të kontaktohet profesori i lëndës. Nëse problemi vërehet pas 48 orëve, kërkesa për rregullim të notës shkarkohet në Webfaqe.

#### 7. Nëse e kam paraqitur një provim gabimisht si mund të rregullohet?

-Nëse problemi vërehet para fillimit të provimeve, ajo mund të korrigjohet në SEMS (opsioni: *fshije*). Pas mbylljes së afatit të paraqitjes së provimeve nuk mund të bëhet ndryshim në listen e provimeve të paraqitura.

#### 8. A ka udhëzues për përdorimin e SEMS-it?

-Udhëzuesi për SEMS mund të gjendet në profilin e përdoruesit.

#### 9. Si të rimerret e drejta e kyqjes në SEMS nëse kam harruar fjalëkalimin?

-Studenti e ka mundësinë e rimarrjes/ndërrimit të fjalëkalimit nëpërmjet adresës së email-it të cilin e ka dhënë në fletëregjistrimin e semestrit.

#### 10. Ku duhet të drejtohem nëse më humb ID kartela?

-Parimisht gjërat e humbura kerkoni tek Zyra e sigurimit në fakultet. Nëse humb ID kartela, duhet të merret raport në Policinë e Kosovës. Me raportin e policisë drejtoheni tek referenti i departamentit për procedurat e mëtejshme për paisjen me ID kartelë të re.

#### 11. Cilat janë arsyet që nuk po më hapet SEMS-i?

-Nëse nuk hapet SEMS-i atëherë mund të provohen zgjidhjet e mëposhtme:

- 1.Rishikoni numrin e ID-së dhe fjalëkalimin në SEMS
- 2.Provojeni qasjen në SEMS me një shfletues (broëser) tjetër.
- 3.Në kohën e paraqitjes së provimeve SEMS-i mund të jetë i mbigarkuar.

#### 12. Si ta pranoj notën në SEMS?

-Pasi të vendoset në SEMS nota vetëm mund të refuzohet, përndryshe pranohet automatikisht.

# Provimet

## 1. Sa afate provimesh ka një vit akademik?

-Një vit akademik ka tre afate të rregullta të provimeve. Ato janë:

- Afati i Janarit
- Afati i Qershorit
- Afati i Shtatorit

Për afatet e parregullta merr vendim senati!

## 2. A ka afate të parregullta çdo muaj për absolventë?

-Nuk ka afate të parregullta për absolventë.

## 3. Cili është kushti për të kaluar në vitin e dytë?

-Për të kaluar në vitin e dytë janë të nevojshme gjithsejt 42 kredi (ECTS)

## 4. Cili është kushti për të kaluar në vitin e tretë?

-Për të kaluar në vitin e tretë janë të nevojshme gjithsejt 36 (ECTS) të vitit dytë + 60 (ECTS) të vitit parë.

## 5. Cilat janë rregullat për pjesëmarrje në provim?

-Rregullat të cilave studenti duhet tu përmbahet janë:

- Provimi duhet të jetë i paraqitur në SEMS.
- Në ditën e mbajtjes së provimit, kandidati duhet ta ketë me vete ID kartelën dhe letërnjoftimin. (Për më gjerësisht hidhni një sy rregullores së Fakultetit që është e ngjitur në hyrje të çdo sallë).

## 6. A janë të obligueshme kolokviumet (testet semestrale)?

-Profesori gjatë prezantimit të syllabusit të lëndës e tregon mënyren e vlerësimit.

# Bursat/ praktika profesionale

## 1. Cilat janë kriteret për të qenë përfitues i bursës Universitare?

-Kriteret për të përfituar bursë universitare janë :

- Të jetë student i rregullt
- Nota mesatare të jetë mbi 9.0

## 2. Si është procedura e aplikimit për bursë?

-Universiteti i Prishtinës në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues, shpallë konkursin për aplikim për bursë në ëeb faqen e Fakultetit Ekonomik <http://ekonomiku.uni-pr.edu/>.

Për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen tek kategoria e njoftimeve në ëeb-faqe të Fakultetit pasi të hapet konkursi.

## 3. A mund të jem përfitues i disa bursave njëkohësisht?

-Për të qenë përfitues i bursës që ofron universiteti ju duhet të gëzoni përfitimin e vetëm kësaj burse, përndryshe nuk mund të aplikoni për bursë universitare. Për çdo informatë dhe përditësim studentët lajmërohen në ueb-faqe të fakultetit pasi të hapet konkursi.

#### 4. A ofron fakulteti praktikë profesionale?

Fakulteti Ekonomik e sheh internshipin si një komponentë kritike të procesit të edukimit. Ne përpiqemi t'i sigurojmë praktikantit një ambient të përshtatshëm pune. Ne e kuptojmë se të tri palët në procesin e internshipit, Fakulteti, studenti dhe sektori në të cilin studenti kryen internshipin, duhet t'i kushtojnë një kohë domethënëse procesit të intern-shipit, në mënyrë që ai të funksionojë si duhet. Internshipi nuk nënkupton që studenti të lihet i pambikëqyrur, duke shpresuar se ai/ajo do të performojë detyrat e tij. Studenti ndonjëherë mund të kryejë detyra pa udhëzime. Sidoqoftë, në të shumtën e rasteve, praktikanti do të kërkojë udhëzime, që nën-kupton angazhim kohor nga mikpritësi i praktikantit. Një internship i suksesshëm kërkon të dyja: kohë dhe energji, që t'i ofrojë praktikantit një punë të mjaftueshme praktike që ta bëjë internshipin të vlefshëm për të. Ky akt balancues mund të jetë i vështirë, por kur të arrihet një internship kualitativ, do të rezultojë me zhvillimin e një punëtori të fuqishëm në të ardhmen. Ekzistojnë disa mënyra të zhvillimit dhe pjesëmarrjes në internship. Sidoqoftë, nëpërmjet punës me mbikëqyrësin e internshipit do të bëhet çdo përpjekje që eksperiencia e internshipit të ketë kuptim.

Po zakonisht publikohen në ëeb-faqen e Fakultetit Ekonomik, dhe gjithashtu ka mundësi për praktika profesionale edhe në Qendrën për Zhvillimin e Karrierës. - Qendrën për Zhvillimin e Karrierës është pjesë e Rektoratit dhe gjindet tek biblioteka universitare.

## Orari i punës së zyrtarëve

### 1. Cili është orari i punës së referentëve?

-Referentët punojnë nga e hëna në të premte nga ora 10:00 deri në orën 15:00, me përjashtim të enjtës kur nuk punohet me palë (pauza: 12:00-13:00).

### 2. Cili është orari i konsultimeve të stafit akademik – profesorëve?

-Orari i konsultimeve me stafin akademik gjendet në ëeb-siten e fakultetit në vegzën e mëposhtme:

[http://ekonomiku.uni-pr.edu/Shpallje-dhe-rezultate-\(1\)/Bachelor/Orari-i-konsultimeve-me-Profesore.aspx](http://ekonomiku.uni-pr.edu/Shpallje-dhe-rezultate-(1)/Bachelor/Orari-i-konsultimeve-me-Profesore.aspx)

### 3. Si mund të kontaktoj me profesorët/asistentët?

-Për të kontaktuar me profesorët/asistentët për çfarëdo nevoje, të dhënat kontaktuese gjenden në CV-të e profesorëve/asistentëve në ëeb-site.

### 4. Cili është orari i konsultimeve në dekanat/sekretari?

Dekani: E martë, 14:00-16:00

Pro-dekani: E mërkurë, 14:00-16:00

Sekretari: E hënë/E mërkurë, 10:00-12:00

### 5. Kur është e hapur biblioteka (ditët/ora)?

E hënë- E premte: 08:00-18:00; e shtunë 08:00-14:00.

Të dielën biblioteka nuk është e hapur.

### 6. A është e obligueshme të regjistrohem në bibliotekën e fakultetit?

-Jo, nuk është e obligueshme. Biblioteka është e hapur për të gjithë studentët e Fakultetit Ekonomik.



# Diplomimi

## 1. Cila është procedura e diplomimit?

-Procedurat e nevojshme për diplomim të studentit janë:

- Studenti paraqet temën e diplomës në SEMS
- Studenti në zyrën nr.7 cakton terminin për verifikimin e notave.

Verifikimi fillon në bazë të kësaj agjende:

Ditët	Departamentet
E Martë	Banka,financa dhe kontabilitet; Kontabilitet
E Mërkurë	Menaxhment dhe informatikë
E Enjte	Marketing
E Premte	Ekonomiks

Pas verifikimit të notave, studentit që e ka pregaditur temën e diplomës i dorëzon dokumentet çdo të Premte në zyrën nr.7 për mbrojtje të temës së diplomës.

Dokumentat e nevojshme për diplomim janë:

- **Dokumentat e shkollës së mesme** që tërhiqen në sportele sipas departamenteve (dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa origjinali qëndron tek studentit.)
- **Fletëpagesat nga SEMSi.** (Studenti duhet të shkarkoj çertifikatë të diplomës nga Fakulteti dhe diplomën nga Universiteti dhe të njëjtat ti paguaj në ndonjë nga institucionet të licensuara për pagesa).
- **Tema e diplomës e nënshkruar nga profesori** (në formatin e shtypur me lidhje të fortë dhe në CD)

Pas dorëzimit të këtyre dokumenteve caktohet orari i diplomimit në përputhje me orarin javorë të departamentëve.

Orari i diplomimit për departamente:

Ditët	Departamentet
E Marte	Banka,financa dhe kontabilitet; Kontabilitet
E Mërkure	Menaxhment dhe informatikë
E Premte	Marketing; Ekonomiks

Pasi diplomon studentit i protokolon dokumentet e diplomimit në arkiv dhe pret deri sa nota e punimit të diplomës ti del në transkripto ( **JU LUTEMI PËR DURIM, NOTA VENDOSËT PAS 48 ORË NË SEMS!**).

Çdo të Martë bëhet mbyllja e dosjes, ndërsa tërheqja e çertifikatës së diplomës bëhet çdo të Hënë në ora 15:00

Kur nota e diplomës vendoset në SEMS dhe kur fletëparaqitja nënshkruhet nga mentori dhe antarët e komisionit, studentit lajmërohet në zyrën për diplomim (zyra 7) për përmbyllje të dosjes.

**Vërjetje:** Studentit pa verifikim dhe pa punim të diplomës të nënshkruar nga ana e mentorit nuk i lejohet mbrojtja e temës dhe procedura shtyhet për javën e ardhshme.

## 2. Kur janë afatet për diplomim?

-Afati për diplomim është gjithmonë i hapur vetëm duhet përcjellur procedurat e caktuara.  
( Në të ardhmen mund të ketë ndryshime rreth afateve)

## 3. A mund të diplomosh tek një profesor me të cilin nuk ke mbajtur asnjë lëndë?

-Studenti mund të diplomoi tek cilido profesor i cili ligjëron lëndët të cilat janë në planprogram të drejtimit të tij.

## 4. A njihet diploma ime ndërkombëtarisht?

-Diploma e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës njihet në të gjitha universitetet e botës ku përdoret sistemi i Bolonjës.

-Secili universitet i ka kriteret e veta, si rrjedhojë universiteti në të cilin aplikoni përcakton se a duhet t'u nënshtrohesh provimeve shtesë.

## 5. A mund të bëj kërkesë për diplomim të parakohshëm nëse më nevojitet për studime master jashtë vendit?

-Studenti duhet të ketë provimet dhe punimin e diplomës të përfunduara. Afati për diplomim është gjithmonë i hapur ( Në të ardhmen mund të ketë ndryshime rreth afateve ).

## 6. Kur duhet diplomuar për të aplikuar në master?

-Studenti duhet të diplomoj para se të hapet afati për aplikim në master. Zakonisht afati hapet në shtator ose tetor dhe shpallet në website-in e universitetit dhe të fakultetit.

## 7. Kur hapet afati për master?

-Zakonisht afati hapet në shtator ose tetor dhe shpallet në website-in e universitetit dhe të fakultetit.

## 8. Për sa kohë pas diplomimit mund ta marr certifikatën e diplomës?

- Pas procedurës së diplomimit certifikata e diplomës merret për 7 deri 10 ditë.

## 9. Ku duhet të dorëzohet kërkesa për diplomim?

-Kërkesa për diplomim bëhet në zyrën për diplomim.

**-Informatë shtesë:** Studentët që nuk kanë diplomuar pas përfundimit të statusit si absolvent, duhet të paguajnë semestrin edhe nëse janë në fazën e punimit të diplomës. Statusi i absolventit vlen për një periudhë 1 vjeçare pas përfundimit të ligjëratave.